

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS:

**Blerje materiale pastrimi**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

**39830000-9**, produkte pastrimi

VLERA E FONDIT LIMIT:

**1.365.403 ( një milion e treqind e gjashtëdhjetë e pese mijë e katerqind e tre) Lekë pa Tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Vau Dejës (Njësia e Prokurimit)** , ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, në masën 2 % të fondit limit , vlera 27.308 ( njëzet e shtatë mijë e treqind e tete) lekë, sipas Shtojcës 3;*

*b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 8*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Fusha e veprimtarisë së operatorit ekonomik ofertues duhet të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të çertifikuar nga organet tatimore. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës.

**2.2.2** Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të jetë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

**Shënim:** Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i

ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

**2.2.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2025 sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete. *(Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Shtojcës 8. Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara shpalljes fitues, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimin e shlyerjes së taksave vendore).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2025 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më pak se 20% të fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; a) Kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara ose vërtetimin për realizimin me sukses të kontratës shoqëruar me faturat tatimore të shitjes, ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara. b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” në kushtet kur kjo procedurë prokurimi klasifikohet procedurë e hapur e thjeshtuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Në zbatim të nenit 55, pika 4/b në kushtet kur kjo procedurë prokurimi është procedurë e thjeshtuar të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.*

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

#### **2.4.Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

**2.4.1** Operatori ekonomik ofertues, në rast se nuk është prodhues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim distributor të autorizuar ku të vertetohet lidhja me prodhuesin, për mallrat objekt prokurimi, i cili duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit, si telefon, fax, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 40, pika 5, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i cili përcakton se: ”Për të provuar

përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

**2.4.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë ditën e hapjes së ofertës mostra për artikujt 1,2,4,27,32,33 dhe këto produkte duhet të jenë të pajisura me Skedat Teknike, Çertifikatën e Sigurisë, Çertifikatën e Cilësisë nga Prodhuesi, Çertifikatën e Konformitetit CE. Mostrat duhet të jenë në ambalazhet origjinale dhe në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara dhe të paraqitura në ofertën teknike. Mosparaqitja e mostrave, dorazi ,në ditën e hapjes së ofertave është kusht skualifikues.

- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues.
  - Mostrat duhet të paraqiten për artikujt objekt i këtij prokurimi
  - Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara.
- Operatori ekonomik duhet të deklarojë se mallrat që do të dorëzojë do të jenë të njëjtë me mostrat e paraqitura ditën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të cilës merr përsipër të kryerje shërbimin e transportit të të gjithë artikujve të kërkuar në adresën e autoritetit kontraktor.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave

**2.4.3** Operatori ekonomik të vertetojë (me deklaratë) që artikujt (solucionet) objekt prokurimi, të kenë afat perdorimi të paktën 1 vit nga, momenti i lidhjes së kontratës.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar dhe do të ofrojë produktet e kerkuara me cilesi, pasi keto produkte do të perdoren per nevojat e institucionit , azilit, konviktit dhe shkollave brenda vitit dhe prandaj eshte e domosdoshme qe produktet te jene cilesore dhe konkretisht me afat perdorimi 1 vit.

**2.4.4** Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë çertifikate të menaxhimit të cilësisë ISO 9001-2015/2018 ose ekuivalente (ose version të përditësuar) që i referohet objektit të prokurimit, nga Prodhuesi, ose nga distributori i autorizuar. (Çertifikata duhet të jetë e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-seNr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ne baze te Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku percaktohet se kjo Çertifikate duhet të jetë lëshuar nga organizma çertifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

## **II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Specifikimet teknike janë hartuar nga njësia e prokurimit sipas kontratave të ngjashme në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për mallra të cilat ndihmojnë stafin e AK në proceset e punës së tyre të përditshme. Specifikimet

teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, e konkretisht:

- Ligji nr. 10216, datë 21.1.2010 “Për detergjentet”, i ndryshuar;
- Ligji nr.10480, datë 17.11.2011 “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve jo ushqimore”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9870, datë 4.2.2008 “Për standardizimin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”, i ndryshuar.

Produktet duhet të jenë të sigurta, në kushte normale ose të arsyeshme, përfshirë kohëzgjatjen sipas rastit dhe kërkesat për vendosjen në treg. Produktet duhet të jenë të paketuara me materiale të riciklueshme ose të kompostueshme, duke minimizuar ndikimin mjedisor. Të jenë të përshtatshëm për lëkurën dhe pëlkurat duke reduktuar rrezikun e acarimit dhe dëmtimit.

Materialet e pastrimit duhet të kenë cilësi, standarde dhe të ofrojnë pastrim me higjienë të lartë. Produktet e materialeve të pastrimit duhet të jenë sa më ekologjike, pak të dëmshme për ambientet dhe jo alergjike ndaj personave që kanë kontakt të drejtpërdrejtë me to. Materialet e pastrimit janë produkte të shumëllojshme dhe ka një gamë të gjerë mallrash në treg. Shumë nga këto prodhohen brenda vendit ashtu siç edhe importohen nga jashtë vendit.

Detergjentët klasifikohen e paktohen në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 27/2016 “PËR MENAXHIMIN E KIMIKATEVE” dhe me aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Nën ndikimin e kushteve të jashtme, vetitë e produkteve ndryshojnë. Për të ruajtur cilësinë e tyre, ato ambalazhohen. Ambalazhi mbron nga temperatura, presioni, lagështia, nga ndikimi i insekteve, mikroorganizmave etj. Ambalazhi i zgjedhur mirë, siguron mbrojtje nga çdo ndikim fizik apo mekanik, si dhe nga efektet atmosferike. Por, ambalazhimi kërkohet gjithashtu për të mbrojtur mjedisin njerëzor nga efektet e produktit të ambalazhuar. Ambalazhimi zgjidh problemin kryesor të shitjes, që është mbrojtja e cilësisë së produktit derisa të arrijë te përdoruesi. Sipas përkufizimit në standardin ISO 8402, sipas të cilit, cilësia është një grup i të gjitha vetive dhe karakteristikave të produktit ose shërbimit që lidhet me aftësinë e tyre për të përmbushur nevojat e përcaktuara ose të shprehura në mënyrë indirekte të përdoruesve. Mallrat duhet të jenë të ambalazuara si më poshtë:

- Ambalazhimi të jetë në formë të dukshme, në një mënyrë të përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e mallrave gjatë transportimit.

- Ambalazhimi luan një rol të rëndësishëm në reduktimin e rreziqeve të sigurisë dhe cilësisë së produktit.
- Ambalazhet duhet të jenë lehtësisht të identifikueshme, të markueshëm e të etiketueshëm, të hapen kollaj, të kenë volume të përshtatshme përdorimi dhe etikë në paraqitje.
- Etiketat duhet të jenë qartësisht të lexueshme dhe të kuptueshme. Të jenë të shkruara rregullat e përdorimit dhe përbërësit në etiketën e çdo produkti për t'u mbrojtur nëse ka lëndë të rrezikshme.
- Për solucionet “lëng” ambalazhimi / paketimi të jetë në shishe/bidona/kontenier plastike.
- Për solucionet “pluhur” ambalazhimi/ paketimi të jetë në paketim kartoni/ plastik. Mbi ambalazh të vendoset etiketa me të dhënat e mëposhtme:
  - Emri i produktit
  - Pesha
  - Emri i markës prodhuese (emri tregëtar i produktit), adresa e plotë e kompanisë prodhuese dhe/ose tregtuese, numri i telefonit, si dhe adresa postare elektronike e personit përgjegjës për vendosjen e produktit në treg (kur është e mundur).
  - Data e prodhimit për produkte të caktuara, përveç atyre që në logon e paketimit/ ambalazhimit përcaktohet vlefshmëria për periudha 12/ 24/ 36 muaj nga momenti i hapjes për përdorim të produktit.
  - Treguesit kryesor fiziko-kimik.
  - Specifikimet e kërkuara (përmbajtja, sipas kushteve specifike; informacioni i nevojshëm për të dhënat e përbërësve për detergjentet, si dhe udhëzimet për përdorim dhe për etiketim).
  - Etiketa e vendosur në çdo produkt të kërkuar të jetë në gjuhën shqipe ose e përkthyer në gjuhën shqipe.

Nr	Emertimi	Specifikimet teknike	Njesia
----	----------	----------------------	--------

1	Solucion larës dyshemeje (pllakash) (1 liter)	<p>Solucion larës dyshemeje (pllakash): me veti të mira pastruese dhe aromatizuese.</p> <p>Ambalazhimi në shishe plastike. Gjendja fizike: të jetë solucion lëng, me aromë parfumi.</p> <p>Vlera e PH të jetë 5 deri në 10. Paraqitja fizike e solucionit të jetë homogjene. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm<sup>3</sup> -1.1 gr/cm<sup>3</sup></p> <p>. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë jo më shumë se 10%. I përshtatshëm për vende higjienike, dhoma zhveshje, palestra dhe kudo ku ka probleme arome të pakëndshme. Ambalazhimi në bidon plastik me konfeksione sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.</p>	cope
2	Solucion larës xhamash (750 ml)	<p>Solucion larës xhamash: me efekt pastrimi dhe shkëlqim të xhamave. Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm sprucimi. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjen, të ketë aromë parfumi. Vlera e PH 5 deri në 11. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Solucioni të jetë homogjen dhe të ketë densitet 0.9 gr/cm<sup>3</sup> deri në 1.2 gr/cm<sup>3</sup> . Lënda tensioaktive të variojë nga 1.0% deri në 4.0%.</p>	cope
3	Sapun i lëngshëm (500 ml)	<p>Sapun i lëngshëm: ambalazhimi nga fabrika në shishe plastike me mekanizëm në pjesën e trupit të shishes për manovrim të produktit gjatë përdorimit. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion viskoz dhe homogjen. Të mos jetë irritues me lëkurën e duarve. Vlera e PH jo më vogël se 5.5 dhe jo më e madhe se 8. Densiteti i lëngut të jetë 0.9 deri në 1.1 gr/cm<sup>3</sup>.</p> <p>Aromë parfumi. Tretshmëria në ujë 100%. Lëndët tensioaktive të jenë nga 5.0 deri në 11%. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.</p>	cope

4	Acid për pastrim (1 liter)	<p>Acid për pastrim: të jetë solucion efikas në heqjen e kripërave të depozituara si dhe papastërtive. Zbardhës alkalin me aftësi vepruese dezinfektante. Ambalazhimi në shishe plastike. Të përmbaje në masën 12% deri në 30% acid klorhidrik. Vlera e pH 0-3. Densiteti i acidit të jetë 1.0 deri 1.5 gr/cm<sup>3</sup>. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.</p>	cope
5	Solucion larës WC dezinfektues (1 liter)	<p>Solucion larës WC dezinfektues: Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm për pastrim më të thellë të anëve të WC. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Vlera e pH të jetë jo më e madhe se 13 dhe tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm<sup>3</sup> deri në 1.1 gr/cm<sup>3</sup>. Përmbajtja e klorit të jetë jo më e madhe se 3.5%.</p>	cope
6	Solucion për pastrimin e smërcit/kriprave nga hidrosanitaret me mekanizëm sprucimi (1 liter)	<p>Solucion për pastrimin e smërcit/kriprave nga hidrosanitaret me mekanizëm sprucimi: Ambalazhimi në shishe plastike për larje të lavamanit, sanitaret e tualetit, të pastrojë në thellësi kripërat e ujit nga hidrosanitaret. Të parandalojë krijimin e kripërave. Të ketë aromë parfumi dhe substanca mbrojtëse për lëkurën e duarve. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjene. Vlera e PH jo më e madhe se 2.5 dhe jo më e vogël se 1.5. Të jetë i tretshëm në ujë. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.</p>	cope

7	Solucion larës enësh lëng ( 1 liter)	<p>Solucion larës enësh lëng: me efekt pastrimi të thellë. Ambalazhimi në shishe plastike dhe të ketë analizën spektrale në etiketë. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion homogjen dhe viskoze, të ketë aromë parfumi. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Vlera e PH 6 deri në 10.</p> <p>Densiteti të variojë nga 0.9 gr/cm<sup>3</sup> deri në 1.2 gr/cm<sup>3</sup></p> <p>. Lënda tensioaktive të jetë nga 15% deri në 20%.</p>	Cope
8	Solucion për zhbllokim lavamani ( 1 liter)	<p>Solucion për zhbllokim lavamani: me efekt zhbllokimi të shpejtë, të mos krijojë shkumë dhe të mos dëmtojë tubat plastike. Ambalazhimi në qese plastike ose kuti kartoni trajtë pluhuri sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.</p>	Cope
9	Aromatik per zyra (300 ml)	<p>Aromatizues zyre: Të jetë me sprucim, i përshtatshëm për ambiente zyre. Neutralizon aromën e ambientit, shpërndan aromë të freskët.</p>	Cope
10	Shkopa inoksi	<p>Shkopa inoksi: jo më të shkurtër se 120 cm. Materiali i shkopit të jetë alumini me veshje plastike. Të ketë mekanizëm montues (efekt vidhimi) dhe shumë rezistent.</p>	Cope
11	Shtupë për larje dyshemeje	<p>. Shtupë për larje dyshemeje: përbërë nga fibra tekstili me përbërje pambuku që thithin ujin shumë mirë. Dendësia e shtupës të jetë jo më e vogël se 250 gr. T'i bashkëngjitet shtupës, shkopi me veshje plastike me gjatësi normale, jo më të shkurtër se 100 cm, të jetë me efekt vidhimi. Materiali i shkopit të jetë alumini nga brenda dhe plastik nga jashtë.</p>	Cope
12	Lecka për larje xhamash (përmasa 32 x 32 cm)	<p>Lecka për larje xhamash: Lecka të jetë me material mikrofibër, e përbërë me 80% poliester dhe 20% poliamid.</p>	cope
13	Peceta pluhurash të thjeshta (3 fije/pako)	<p>Peceta pluhurash të thjeshta: Të jenë të paketuara në qese min 3 fije/pako. Të jenë me shumë se një përdorimëshe. Të kenë veti të mira përthithëse</p>	pako

14	Peceta pastrimi mikrofibër (3 fije/pako)	Peceta pastrimi mikrofibër: Të jenë cilësore, të përshtatshme për pastrimin e mobiljeve të ndryshme, me aftësi super thithëse të jenë me ambalazhim min 3 fije/pako.	pako
15	Fshesë me sfungjer dhe gomë për pastrimin e xhamave		Cope
16	Sfungjer për pastrim hidrosanitaresh	Sfungjer për pastrim hidrosanitaresh: Të jetë me pore të vogla në përbërjen e sfungjerit dhe me rrjetë teli të butë për pastrim sipërfaqesh të ashpra. Anësoret të jenë me kanal për mbrojtjen e duarve.	Cope
17	Doreza gome	Doreza gome: të jenë rezistente ndaj kimikateve të detërgjontëve dhe kimikatëve të pastrimit. Të jenë për përdorim të larjes së murit e pllakave. Të jenë të qëndrueshme dhe të përshtatshme në përdorim dhe të padepërtueshme nga lëngjet.	pale
18	Doreza Latex ose Nitrile	Doreza Latex ose Nitrile: josterile, me ose pa pudër, njëpërdorimshe, në masat XS, S, M, L, XL (sipas kërkesës së punonjësve), të jenë të paketuara në pako kartoni ose plastike, me minimumi 100 copë/pako. Të ketë çertifikimin CE ose FDA ose ekuivalent. Afati i skadencës të jetë të jetë të paktën 6 muaj nga koha e furnizimit. Të ambalazhuara në mënyrë të tillë që të mos kontaminohen gjatë shpërndarjes	pako
19	Fshesë pastrimi pa bisht	Fshesë pastrimi pa bisht: Fshesa të jetë me fije të dendura, të buta plastike, me gjatësi mbi 10 cm. Të jetë për pastrim të ambienteve të brendshme. Të jenë rezistente gjatë forcës së fshirjes së sipërfaqes. Koka të jetë e montueshme dhe e çmontueshme me mekanizmin e rrotullimit nga e djathta në montim me shkopin. Vendi i vendosjes së shkopit të jetë standard. Peshë e saj të jetë jo më e vogël se 340 gr.	Cope
20	Furça për pastrimin e WC-së	Furça për pastrimin e WC-së: të jetë me fije të forta sintetike. Furçë për pastrim efikas dhe higjienik për pastrimin e sipërfaqeve të vështira. Furça të ketë mbajtësen e saj. Të jetë me peshë jo më shumë se 300 gr.	Cope
21	Furce pastrimi lavamani	Furça pastrimi lavamani: Furçë për pastrim efikas dhe higjienik. Bishti të jetë i përshtatshëm me pëllëmbën e dorës, fijet e furçës të jenë të forta për të pastruar sipërfaqet e	Cope

		vështira të lavamanit. Pesha jo më e vogël se 190 gr. Gjatësia e furçës jo më pak se 30 cm.	
22	Kuti mbledhëse plehrash (kaci) me gominë dhe me bisht plastik	Kuti mbledhëse plehrash (kaci) me gominë dhe me bisht plastik: jo më pak se 70 cm të gjatë. Kacia të ketë gjerësi 21 cm, gjatësi 29 cm, thellësi 10 cm, +/- 2 cm marzh gabimi.	Cope
23	Kovë pastrimi e thjeshtë për shtupë (5 litër)	Kovë pastrimi e thjeshtë për shtupë: Të jetë e thellë dhe të ketë një dorezë mbajtëse nga sipër për transportimin e kovës. Kapaciteti mbajtës i kovës të jetë me volum min 5 Litër.	Cope
24	Kosh plastik për hedhjen e mbeturinave (30 litër)	Kosh plastik për hedhjen e mbeturinave, të jetë në formë drejtkëndore ose rrethore, me kapak nga sipër që hapet si dritare. Kapaciteti mbajtës i koshit të jetë me volum min 30 Litër.	Cope
25	Letër duarsh me kuti (250 fije)	Letër duarsh: me kuti, fletë palosje zig zag me përberje 100% celuloze. Të jetë e paketuar në kuti ose në qese min 250 fije/pako. Letra të ketë mundësi thithje të lartë	Pako
26	Letër guzhine e paketuar (10m)	Letër kuzhine e paketuar: Letra të jetë e paketuar, standard me rula. Të jetë cilësore. Të jetë 10 m dhe të jetë me shkëputje.	Rulon
27	Letër higjienike e paketuar (min 10 rulon/paketim)	Letër higjienike e paketuar: Të jetë me paketim min 10 rulon/pako, fletëpalosje zig-zag në pako me fije dhe me shkëputje. Të jetë cilësore dhe e butë. Të jetë e tretshme në ujë.	Pako
28	Qese mbeturinash (35 litër)	Qese mbeturinash: Të jenë rezistente, të kenë kapacitet mbajtës min 35 litër dhe të përmbajë min 15 fije, të jenë të forta, materiali plastmasi. Të jenë të paketuara në formë ruloje. Gryka e qeses të jetë pa ose me lidhëse. Të jetë produkt i biodegradueshëm.	Pako
29	Tel enesh	Tel enësh: Të jenë të rezistueshëm, të përshtatshëm për larje tenxheresh dhe kazanësh. Të jetë material që nuk ndryshket.	Pako
30	Detergjent kundër yndyrnave (1 l)	Detergjent kundër yndyrnave: efikas kundër njollave më të forta. Në gjendje të lëngët, kundër yndyrës për të gjitha llojet e rrobave. Efektiv në të gjitha temperaturat e ujit.	cope

31	Detergjent kundër njollave (sgrasatore)(750 ml)	Detergjent kundër njollave (sgrasatore): largon pluhurin, vajin dhe ndotësit e tjerë. Me veti zbutëse të papastërtive.	cope
32	Pluhur larës lavatriçe për rroba të bardha	Pluhur larës për lavatriçe, për rroba të bardha: të ketë aftësi vepruese dhe pastruese të larta. Pamja e jashtme: masë e pluhurizuar, e granular. Densiteti të jetë nga 0.6 gr/cm <sup>3</sup> deri në 1.1 gr/cm <sup>3</sup> . Vlera e pH të jetë 9 deri në 11. Tretshmëria në ujë më e madhe ose e barabartë me 95%. Të përmbajë lagështi jo më shumë se 10%. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë 5% deri 15% dhe ≤ 5% për lëndët tensioaktive kationike dhe anionike. Përmbajtja e perboratit të jetë jo më pak se 2 %. Aftësia shkumuese të jetë më e vogël se 5 cm. Ambalazhimi në qese plastike/kuti kartoni, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor. Aktiv në të gjitha temperaturat dhe me çdo lloj fortësie uji. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.	kg
33	Pluhur larës lavatriçe për rroba me ngjyrë	Pluhur larës lavatriçe për rroba me ngjyrë: të ketë aftësi vepruese dhe pastruese të larta. Pamja e jashtme: masë e pluhurizuar, e granular. Pluhur me enzima dhe përbërje të avancuar. Përmban sapun, kripra fosfori dhe elementë zbardhës me bazë oksigjeni që japin efekt dhe në ujë të ftohtë dhe temperatura të ulëta. Densiteti të jetë nga 0.6 gr/cm <sup>3</sup> deri në 1.1 gr/cm <sup>3</sup> . Vlera e pH të jetë 9 deri në 11. Tretshmëria në ujë më e madhe ose e barabartë me 95%. Të përmbajë lagështi jo më shumë se 10%. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë 5% deri 15% dhe ≤ 5% për lëndët tensioaktive kationike dhe anionike. Aftësia shkumuese të jetë më e vogël se 5 cm. Ambalazhimi në qese plastike ose kuti kartoni sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.	kg
34	Solucion zbutës dhe aromatizues rrobash (5 l)	Solucion zbutës dhe aromatizues rrobash: Ambalazhimi në shishe plastike. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike të jetë solucion homogjen, me aromë parfumi. Vlera e PH nga 6.5 deri në 7.5. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm <sup>3</sup> deri në 1.3 gr/cm <sup>3</sup> . Të jetë i tretshëm në ujë 100%.	cope

35	Alkool etilik 70 % ( 1liter)	Alkool etilik 70%: antiseptik dhe dezifektant i përshtatshëm për përdorim të jashtëm, me spektër të gjerë veprimi kundër baktereve, viruseve, majave/kërpudhave. Përdoret për dezifektim të objekteve të ndryshme, mobilje, pajisje elektroshtëpiake etj.	liter
36	Shampo për larje koke (500 ml)	Shampo për larje koke: të ketë aftësi pastruese të zbokthit dhe zbutjes së flokut gjatë larjes. Ambalazhimi në shishe plastike. Gjendja fizike e lëngut homogjen, të ketë aromë të këndshme. Vlera e PH të jetë 6-7. Viskoziteti në 20°C të jetë jo më i vogël se 15,000 cp dhe jo më i madh se 25,000 cp. Densiteti i lëngut në temperaturën 20°C të jetë jo më i madh se 1,025 +/- 0,025 g/ml. Të jetë i tretshëm në ujë. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës	Cope
37	Shampo për larje trupi (500 ml)	Shampo për larje trupi: të ketë aftësi pastruese. Ambalazhimi në shishe plastike. Gjendja fizike e lëngut të jetë lëng homogjen, të ketë aromë të këndshme. Vlera e PH të jetë 6-7. Viskoziteti në 20°C të jetë jo më i vogël se 10,000 cp dhe jo më i madh se 15,000 cp. Densiteti i lëngut në temperaturën 20°C të jetë jo më i madh se 1,016 +/- 0,005 g/ml. Të jetë i tretshëm në ujë. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.	Cope
38	Sapun rrobash (100 gram)	Sapun rrobash: Të jetë cilësor, me aftësi shkumuese të lartë. Ambalazhimi nga fabrika. Paraqitja fizike të jetë i ngurtë, paketimi të ketë të evidentuar markën dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Vlera e pH të jetë 7 deri në 10. Densiteti të jetë 0.9 deri në 1.2 gr/cm <sup>3</sup> . Tretshmëria në ujë të jetë jo më e vogël se 95%. Lartësia e shkumës të jetë jo më e madhe se 5 cm	Cope
39	Kosha tualeti me pedale (3 Litër)	Kosha tualeti me pedale: Kapaciteti: të jetë me volum min 3 Litër. Materiali metalik me qëndrueshmëri të lartë, rezistent ndaj ndryshkjes. Hapja dhe mbyllja e tij të realizohet me anë të pedales.	cope

40	Mbulesë tavoline letre (përmasa 1x1)	Mbulesë tavoline letre: Të jetë një përdorimshe dhe të jetë cilësore	cope
----	--------------------------------------	----------------------------------------------------------------------	------

*Specifikimet teknike gjenden në shtojcën 5 të Dokumentave Standarte të Tenderit.*

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

## **NJESIA E PROKURIMIT**